

ABSTRAK

Regjistrimi i pronësisë dhe të drejtave të tjera sendore në Kosovë dhe Shqipëri në këtë punim ka qenë objekt studimi për arsye të shumëta e ndër to është edhe ajo se në praktikë kemi shumë raste të cilat janë kryer transaksione joformale, shitëblerje të ndryshme por ato nuk janë regjistruar asnjëherë dhe kjo ka bërë që të lindin probleme të mëdha sa i përketë definimit të pronësisë.

Blerësit apo më mire të themi poseduesit të cilet nuk e kanë të regjistruar pronësin e kanë shumë të vështirë më vonë që ta dëshmojnë atë , e sidomos kjo vështirsohet edhe më shumë në qoftë se ata kundërshtohen nga pronari i cili e ka certifikatën e pronësisë dhe kështu ata e humbin rastin në gjykata , po ashtu problem tjetër është edhe shitja e një palujtëshmeri më tepër se një herë , dy apo edhe më shumë dhe të drejtën e ka ai i cili e ka regjistruar palujtëshmërin në regjistrat e palujtëshmerive.

Në këto raste shitësi që nuk e ka të regjistruar të drejtën sendore në emër të tij, ai do të jetë përgjegjës ndaj blersve të cileve ua ka shitur dhe kështu ai do të duhet që të kompensoj dëmin që u ka shkaktuar blersve për shkak se ka shitur një send me mungesa juridike.

Në punim është bërë dallimi në mes të dy vendeve Kosovë dhe Shqipërisë sa i përketë fitimit të pronësisë dhe regjstrimit e po ashtu edhe rolit të regjistrave që në një shtet ka karakter konstitutiv e në një shtet ka karakter deklarativ

Fjalët kyçe: pronësia dhe të drejtat e tjera sendore , fitimi i pronësië dhe mënyra e fitimit të pronësië , regjistrimi i pronësisë dhe të drejtave të tjera sendore, roli i regjistrave dhe efektet e tyre deklarative-konstituiv , parashkrimi...

Mentori:

Prof.Dr.Abdulla Aliu

Kandidati:

Faton Sadiku